



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

KA.nr.3-5/2022

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë prej Shpetim Sadiku – Kryetar Kolegji, Kadri Syla dhe Agim Shala - anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti Administratore e Zyrës Disiplinore në OAK-ë, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vendosur sipas ankesës nr. 3-4/2-22 të datës 10/05/2022 e ushtruar nga Avokati _____, kundër vendimit të Kolegjit Disiplinor KD.nr.3-3/2022 datës 18/03/2022, në seancën jo publike të mbajtur me datë 03/06/2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e ushtruar nga i paraqituri Avokat _____ me seli të zyrës në _____ si e bazuar, **NDRYSHOHET** vendimi i Kolegjit Disiplinor KD.nr.3-3/2022 datës 18/03/2022.
- II. HUDHET** Propozimi i Prokurorit Disiplinor të OAK-së nr.36-06/2020 të datës 09/02/2022 për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes disiplinore.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të OAK-së.

A r s y e t i m

Kolegji Disiplinorë me Vendimin KD.nr.3-3/2022 datës 18/03/2022, ka shpallur përgjegjës të paraqiturin Avokat _____ me seli në _____ sepse me datën 05/05/2020 gjatë debatit në televizionin publik RTK kishte fyer zyrtarin e _____ me fjalët “a i ngjan nënes sate apo motrës” duke e bërë të njëjtin të ndihet keq disa herë, me çka ka kryer shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 119 të statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të KEPA-s, sepse me këtë ka fyer debatuesin duke nxitur reagimin e qytetarëve në adresë të OAK-së duke cenuar kështu autoritetin e avokatisë. Kolegji Disiplinor në pajtim me nenin 123 paragraf 3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 51 paragraf 1, nënparagraf 1.2 të Ligjit për Avokatinë, të paraqiturit, Avokatit _____ i ka shqiptuar masën disiplinore Gjobë në shumë prej 500 €, si dhe në emër të paushallit disiplinor shumë prej 50 €, me paralajmërimin se gjoba dhe paushalli duhet të paguhet në buxhetin e OAK-së, në afat prej 15 dite nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij vendimi, në afatin ligjor, ka ushtruar ankesë, Avokati _____ me seli në _____

Kolegji i Ankesave në seancën jopublike të mbajtur me datën 03/06/2022, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresvave të lëndës njëzëri vendosi se në këtë çështje disiplinore është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes disiplinore.

Nga fletparaqitja e ushtruar nga ushtruesi i saj [redacted], si dhe provat që janë në shkresat e lëndës vërtetohet se i paraqituri me datën 05/05/2020 gjatë debatit në televizionin publik RTK kishte fyer zyrtarin e [redacted] me fjalët “a i ngjan nënes sate apo motrës” duke e bërë të njejtin të ndihet keq disa herë, me çka ka kishte për të kryer shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 119 të statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të KEPA-s.

Zyra e Prokurorit Disiplinor pranë Kolegjit Disiplinor me datën 09/02/2022 ka ushtruar propozimin sipas detyrës zyrtare ndaj të paraqiturit [redacted] për shkelje disiplinore me datën 05/05/2020.

Ndërsa Kolegji Disiplinor me datën 18/03/2022 ka caktuar dhe mbajtur senacën e shqyrtimit kryesor ku të paraqiturin e kanë gjet përgjegjës dhe i kanë shqiptuar masën disiplinore gjobë në lartësi prej 500 €, si dhe në emër të paushallit disiplinor shumë prej 50 €, me paralajmërimin se gjoba dhe paushalli duhet të paguhet në buxhetin e OAK-së, në afat prej 15 dite nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Duke ju referuar dispozites së nenit 56 paragraf 2 të Ligjit për Avokatinë, decidivisht është paraparë *“Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda, parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe për kryesin, kurse gjithsesi parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes”*.

Me qense pretendimi për shkelje disiplinore nga Avokati [redacted] është i datës 05/05/2020, nga kjo datë e deri tek shqyrtimi i Ankesës nga Kolegji i Ankesave me datën 03/06/2022 kanë kaluar 2 vite e 29 ditë, e që i bie që në këtë çështje disiplinore është arritur parashkrimi absolut kjo në kuptim të dispozites së nenit 56 paragraf 2 të Ligjit për Avokatinë.

Komisioni për Ankesa në mbështetje të dispozitave nga neni 110 paragraf 1 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 56 paragraf 2 të Ligjit për Avokatinë, dhe neni 38, neni 43 paragraf 1, neni 44, të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, u vendos sikur në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
KA.nr.3-5/22 të datës 03/06/2022

Kryetari i Kolegjit për Ankesa
Av. Shpetim Sadiku, Lipjan


